



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

__Gusht 2023

RAPORT ALTERNATIV

Mbi ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për çështjet e përfaqësuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit

1. Përmbledhje Ekzekutive

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) në ushtrim të misionit të tij, vijon të kontribuojë për garantimin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, nëpërmjet ofrimit të ndihmës juridike dytësore ndaj shtetasve pjesë e grupeve të marginalizuara të shoqërisë, përfshirë shtetasit e ndodhur në kushtet e privimit të lirisë në institucionet penitenciare në vendin tonë.

KShH pasi u njoh me përmbajtjen e Raportit Vjetor të 16-të të Komitetit të Ministrave “Supervizimi i ekzekutimit të gjykrimeve dhe vendimmarrjeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për vitin 2022”, si dhe nisur nga detyrimet konventore që rrjedhin nga zbatimi i nenit 46 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), çmoi të nevojshëm hartimin e këtij Raporti Alternativ, me qëllim paraqitjen e gjetjeve dhe konstatimeve në lidhje me situatën ligjore dhe faktike të ekzekutimit të disa prej çështjeve të përfaqësuar para Gjykatës (GJEDNJ), nga avokatët e KShH-së.

Raporti alternativ i KShH-së pasqyron dhe analizon arritjet, sfidat dhe boshllëqet praktike të ndeshura në mbrojtjen dhe garantimin e respektimit të së drejtës së procesit të rregullt ligjor të kërkuesve, elementë substancial i të cilit është edhe ekzekutimi efikas dhe pa vonesai vendimmarrjeve të GJEDNJ-së.

Gjatë harkut kohor 2019-2021, avokatët e KShH-së kanë përfaqësuar pranë Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, tre çështje të rëndësishme si *Prizreni* kundër Shqipërisë (kërkesa nr. 29309/16), *Strazimiri* kundër Shqipërisë (kërkesa nr. [34602/16](#)) dhe *Zaharia* kundër Shqipërisë (kërkesa nr. [45022/16](#)).

Pasi këto vendime kanë marrë formë të prerë, në zbatim të nenit 46 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, i cili parashikon në pikën e parë të tij se “*Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë*”, KShH ka ndjekur dhe mbikëqyrur procedurat e ndërmarra nga autoritetet vendase për ekzekutimin e tyre. KShH vëren me shqetësim se pavarësisht se ka kaluar një kohë e konsiderueshme nga marrja e statusit ‘vendim përfundimtar/final’ nga GJEDNJ, procesi i ekzekutimit mbetet ende në proces të pjesshëm lidhur me të tre vendimet. Më konkretisht, kërkuesve të përfaqësuar nga KShH nuk i është akorduar nga ana e Qeverisë Shqiptare dëmshpërblimi për dëmin material dhe/ose atë jomaterial, të disponuar në vendimmarrjet respektive finale, brenda një afati të arsyeshëm. Në të tre rastet, periudha nga dhënia e vendimit të GJEDNJ deri në publikimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave për akordimin e dëmshpërblimit vlerësohet nga ana jonë si një vonesë e tejzgatur dhe e paarsyeshme. Në



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

rastin Strazimiri k. Shqipërisë, vonesa është 2 vjet e 7 muaj¹, ndërkohë në rastin Prizreni k. Shqipërisë kjo vonesë është 3 vjet e 3 muaj². Edhe pse në nivel më të ulët, i vonuar është dhe publikimi i VKM për ekzekutimin e vlerës së përcaktuar si detyrim rastin Zaharia k. Shqipërisë, pasi 1 viti e 5 muaj, nga dhënia e vendimit përfundimtar nga Gjykata.³ Aktualisht, pasi ka kaluar një kohë e konsiderueshme, është ekzekutuar vetëm detyrimi financiar në favor të kërkuarit Strazimiri. Qeveria në muajin Korrik 2023 bëri të mundur ekzekutimin e detyrimit financiar, ndërkohë që vendimi i GJEDNJ ishte bërë përfundimtar në datën 21.05.2020. Lidhur me këtë fakt në drejtim të KShH nuk ka pasur asnjë njoftim zyrtar nga autoritetet shtetërore. Ndërkohë nuk ka asnjë njoftim zyrtar nga autoritetet shtetërore, si dhe nuk rezulton të jetë ekzekutuar vendimi i GJEDNJ lidhur me kostot dhe shpenzimet gjyqësore në favor të përfaqësuesve ligjorë të këtij shtetasi.

Në të tri çështjet e përfaqësuara nga KShH, kërkuarve u është njohur e drejtë e dëmshpërblimit për dëmin monetar dhe/ose financiar që shkon një vlerë prej 40,000 euro në total si dhe rreth 6,000 Euro janë shpërblim për taksat dhe shpenzimet për përfaqësimin dhe taksat gjyqësore. Nga përfundimi i afatit tre mujor brenda të cilit këto vendime kanë marrë statusin përfundimtar, deri në shlyerje, mbi këto shuma do të aplikohet interesi sipas përcaktimit në vendimmarrjet e GJEDNJ, gjatë periudhës së vonesës. KShH i cilëson problematike vonesat e paarsyeshme në ekzekutimin e masës monetare të dëmshpërblimit kundrejt kërkuarve, të njohura nëpërmjet vendimmarrjeve gjyqësore, nisur nga vështirësitë që kërkuarit hasin në sajë të kushteve të vështira sociale ekonomike në të cilat ata dhe familjarët e tyre ndodhen.

Sipas nenit 46 të Konventës (KEDNJ), konstatimi i shkeljeve nga GJEDNJ vendos mbi Shtetin përgjegjës një detyrim ligjor jo vetëm t'iu paguajë kërkuarve shumat e akorduara me anë të justifikimit të drejtë sipas nenit 41, por edhe të përzgjedhë, për mbikëqyrje nga Komiteti i Ministrave, masat e përgjithshme dhe/ose individuale, nëse është vendi, për t'u miratuar në rendin e tyre ligjor të brendshëm. Këto masa synojnë t'i japin fund shkeljeve të konstatuar nga GJEDNJ dhe për të korrigjuar me sa është e mundur pasojat. Në zbatim të këtij neni, në çështjen Strazimiri, GJEDNJ ka lënë detyra konkrete sa i takon marrjes së masave të një karakteri të përgjithshëm dhe individual. Sa i takon masave të përgjithshme, GJEDNJ ka kërkuar në mënyrë të menjëhershme nga shteti shqiptar, për të siguruar kushtet e duhura të jetesës dhe shërbimet e kujdesit të duhur shëndetësor për personat e diagnostikuar me probleme të shëndetit mendor, të cilët janë të privuar nga liria në rrethanat e një trajtimi të detyruar mjekësor me vendim gjyqësor të gjykatave të brendshme (shqiptare). Por pavarësisht se kanë kaluar 3 vite nga vendimmarrja e GJEDNJ-së, kjo masë e përgjithshme nuk është ekzekutuar, pasi në vendin tonë nuk është ngritur një institucion i tillë që mungon prej afro 3 dekadash. **KShH shprehet kritike në lidhje me kushtet pjesërisht të papërshtatshme të**

¹ Çështja “Strazimiri kundër Shqipërisë”, për kërkesën nr. 34602/16, datë 21.1.2020, dhe është bërë përfundimtar në datën 21.5.2020, ndërkohë vendimi për ekzekutimin e tij ka datën 19.12.2022. Bëhet fjalë për VKM Nr. 819, datë 19.12.2022 “PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 21.1.2020, PËR ÇËSHTJEN “STRAZIMIRI KUNDËR SHQIPËRISË” (PËR KËRKESËN NR. 34602/16)”

² Çështja “Prizreni kundër Shqipërisë”, kërkesa nr. 29309/16, datë 11.6.2019, i cili është bërë përfundimtar në datën 11.9.2019, ndërkohë vendimi për ekzekutimin e tij ka dalë në datën 7.12.2022. Bëhet fjalë për VKM Nr. 860, datë 27.12.2022 “PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 11.6.2019, PËR ÇËSHTJEN “PRIZRENI KUNDËR SHQIPËRISË” (PËR KËRKESËN NR. 29309/16)”

³ Vendimi i GJEDNJ në çështjen Zaharia k. Shqipërisë mban datën 09.11.2021. Nëpërmjet VKM nr. 369, dt. 01.06.2022 “Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 9.12.2021, për çështjen “Fotaq Zaharia kundër Shqipërisë” (kërkesa nr. 45022/16)”.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

akomodimit të shtetasve nën masë mjekësore në dy godinat e IEVP Shënkoll (Lezhë), e cila nga një zgjidhje e përkohshme dhe tranzitore që duhej të ishte, në justifikim të mbylljes së IEVP tepër problematike të Zaharisë, rezulton se nuk është më e tillë. Në mungesë të një institucioni të posaçëm mjekësor, dhe duke parë rritjen gati të pesëfishuar të pacientëve me "masë mjekësore" dhe masë sigurimi personal "shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik" (në raport me numrin më të reduktuar të tyre, 5 vite më parë, pranë IEVP Zahari), KShH vlerëson se hapa konkretë dhe urgjentë duhet të merren për gjetjen e një zgjidhjeje afatgjatë, që garanton trajtimin mjekësor adekuat dhe kushte infrastrukturore që respektojnë dinjitetin njerëzor të kategorisë së pacientëve forensikë (ose siç njihen ndryshe me masë mjekësore).

Si masë individuale, në çështjen *Strazimiri*, GJEDNJ ka kërkuar nga autoritetet të sigurojnë me urgjencë administrimin e formave të përshtatshme dhe të individualizuara të terapisë për kërkuesin, dhe të marrin në konsideratë mundësinë për ta vendosur atë në një mjedis alternativ, jashtë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale. Por edhe kjo masë, nuk rezulton të jetë zbatuar.

Lidhur me ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ për rastet *Strazimiri* dhe *Prizreni*, KShH ka mbajtur korrespondencë zyrtare të vazhdueshme, me institucionin e Avokaturës së Shtetit. Nëpërmjet shkresës nr. 773/41 prot. datë 03.11.2021 Avokatura e Shtetit ka informuar se: "*Ka paraqitur përpara Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës planet e veprimit për ekzekutimin e vendimeve të sipërcituara. Sjellim në vëmendje se planet e veprimit të sipërpërmendura pasqyrojnë të gjitha masat e ndërmarra nga autoritetet shqiptare në zbatim të vendimeve të GJEDNJ-së dhe roli i Avokaturës në këtë proces është koordinues midis institucioneve përgjegjëse sipas fushave respektive*". Hartimi dhe dërgimi përpara Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës të planeve të veprimit mbi ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës, shoqëruar me mosveprimin e organeve shtetërore, ngre pikëpyetje serioze mbi mungesën e vullnetit institucional, për zbatimin e vendimeve të detyrueshme nga shteti shqiptar.

Në vlerësimin tonë, mosekzekutimi në kohë i vendimmarrjeve përfundimtare të GJEDNJ-së, vendos në pikëpyetje efikasitetin e mbrojtjes që Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut garanton me anë të këtij mekanizmi mbrojtës, kur konkludohet me anë të saj, se shteti shqiptar ka shkelur të drejtat dhe liritë konventore të kërkuesve. Kjo vonesë e konsiderueshme në ekzekutimin e vendimmarrjeve të GJEDNJ e shndërron mjetin ankimes para saj, të paefektshëm në rezultat. Në disa raste, shkak i kësaj vonese mund të jetë mosveprimi apo burokracia e aktorëve shtetërorë përgjegjës, ose mungesa e bashkë-koordinimit dhe ndërveprimit të institucioneve shtetërore, dhe jo domosdoshmërisht mungesae burimeve të mjaftueshme financiare. Për KShH-në, si organizatë jofitimprurëse që mbron të drejtat dhe liritë e njeriut, njëkohësisht ndihmuese me shërbim avokator në mbrojtje të interesave legjitime të 3 kërkuesve, këto shkaqe janë të pavarura nga vullneti i kërkuesve, dhedobësojnë besimin e tyre si dhe të publikut në tërësi, tek shteti i të drejtës, dhe funksionimi i institucioneve në përputhje me detyrimet që burojnë nga Konventat Ndërkombëtare ku shteti ynë është palë.

2. Vështrim mbi ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ "Strazimiri k. Shqipërisë"



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

2.1. Detyrimet që burojnë nga ky vendim për shtetin shqiptar dhe masat e raportuara nga institucionet përgjegjëse

KShH ka përfaqësuar pranë GJEDNJ-së, çështjen Strazimiri kundër Shqipërisë, i paraqitur pranë kësaj Gjykate më datë 11 qershor 2016 nëpërmjet kërkesës (nr. 34602/16). Objekt i kësaj kërkesë ishte trajtimi i papërshtatshëm mjekësor i ankuesit, për të cilin GJEDNJ ka konstatuar cenim të nenit 3 (ndalimi i torturës) dhe 5 (e drejta për liri dhe siguri, të Konventës (KEDNJ)). Nëpërmjet vendimit të saj, datë 21 janar 2020, Gjykata vendosi një sërë detyrimesh mbi shteti shqiptar, si vijon:

“.....Shteti përgjegjës duhet të marrë masa të një karakteri të përgjithshëm në mënyrë të menjëhershme për të siguruar kushtet e duhura të jetesës dhe shërbimet e kujdesit të duhur shëndetësor për personat e sëmurë mendërisht, të cilët janë të privuar nga liria në rrethanat e një trajtimi të detyruar mjekësor me urdhër gjykate. Shteti përgjegjës, objekt i mbikëqyrjes së Komisionit të Ministrave, mbetet i lirë të zgjedhë mjetin me anë të cilit do të përmbushë detyrimin e tij ligjor sipas nenit 46 të Konventës. Gjykata është e mendimit se Shteti përgjegjës duhet të krijojë “institucionin e duhur” duke pajisur godinat ekzistuese ose ndërtesën e një godine të re të specializuar për strehimin e personave si kërkuesi për përmirësimin e kushteve të jetesës. Një godinë e tillë duhet të respektojë qëllimin terapeutik të kësaj forme privimi lirie, me synimin për të kuruar ose lehtësuar gjendjen e shëndetit mendor të tëndaluarve, duke përfshirë ku është e mundur, një reduktim ose kontroll mbi rrezikshmërinë e tyre dhe lehtësimin e riintegritimit të tyre në shoqëri. Trajtimi farmakologjik duhet të kombinohet me forma të tjera të njohura për trajtimin terapeutik, si pjesë e një plani të individualizuar trajtimi për secilin individ. Për këto qëllime, autoritetet duhet të sigurojnë edhe rekrutimin e një numri të mjaftueshëm punonjësish të kualifikuar të kujdesit për shëndetin mendor, në këto godina. Për më tepër, autoritetet duhet të marrin në konsideratë, ku është e mundur, mundësinë e trajtimit të shëndetit mendor pa shtrim spitalor. Për sa ka të bëjë me masat individuale, autoritetet duhet të sigurojnë me urgjencë administrimin e formave të përshtatshme dhe të individualizuara të terapisë për kërkuesin, dhe të marrin në konsideratë mundësinë për ta vendosur atë në një mjedis alternativ jashtë institucioneve për ekzekutimin e vendimeve penale.”

.....

"Shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkuesit, brenda tre muajve nga data në të cilin vendimi bëhet i formës së prerë, në përputhje me nenin 44 § 2, të Konventës, shumat e mëposhtme, të cilat duhet të konvertohen në vlerën monetare të Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes:

- i. 15 000 euro (pesëmbëdhjetë mijë euro) plus çdo taksë e cila mund të tarifohet, për dëmin jomonetar,*
- ii. 2 500 euro (dy mijë e pesëqind euro), plus çdo taksë e cila mund të jetë e tarifueshme për kërkuesin, për kostot dhe shpenzimet."*

Pasi ky vendim mori formë të prerë më dt. 21.05.2020, KShH kërkoi informacion nga Avokatura e Shtetit lidhur me hapat e ndërmarrë për ekzekutimin e tij⁴. Zyra e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit bëri me dije se, Plani i Masave i hartuar për ekzekutimin e kësaj

⁴ Nëpërmjet shkresës nr. 681 prot datë 14 Tetor 2021



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

vendimmarrjeje fokusohej në ato të natyrës legjislative, marrjen e masave për transferimin e kategorisë së pacientëve, pjesë e të cilëve është edhe kërkuesi pranë IEVP Lezhë dhe masat për ekzekutimin e dëmshpërblimit financiar që ishte njohur si detyrim për shtetin shqiptar në vendimin e GJEDNJ-së⁵.

Në muajin Janar 2023, Zyra e Avokaturës së Shtetit kërkoi të dhënat bankare të kërkuesit për ekzekutimin e dëmshpërblimit financiar. Në vijimësi, KShH iu drejtua IEVP Shënkoll në muajin Janar 2023⁶ për marrjen e masave për hapjen e një llogarie bankare për shtetasin A.S., i cili në ekzekutim të masës mjekësore ‘mjekim i detyruar në një institucion mjekësor’ ndodhet në këtë institucion. Duke mos pasur një reagim nga ana e IEVP Shënkoll, KShH iu drejtua sërish institucionit pas tre muajsh, me një tjetër shkresë në muajin Prill 2023⁷ duke kërkuar informacion mbi masat e marra për ekzekutimin efektiv të vendimmarrjes. Në përgjigje të kërkesës së fundit të adresuar, IEVP Shënkoll (Lezhë) njoftoi hapjen e llogarisë bankare për këtë shtetas. Vonesa argumentohej e ndërlidhur me mungesën e dokumentit të identifikimit të shtetasit, kriter kyç, për hapjen e llogarisë bankare. Avokatët e KShH-së kanë marrë masa për adresimin e të dhënave bankare drejt Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për dijeni Avokaturën e Shtetit. Ndërkohë detyrimi financiar në favor të kërkuesit Strazimiri është ekzekutuar nga Qeveria në muajin Korrik 2023. Vendimi i GJEDNJ mbi këtë rast ishte bërë përfundimtar në datën 21.05.2020. Në vlerësimin e KShH koha e kaluar nga marrja e vendimit të GJEDNJ formë të prerë, deri në ekzekutimin e dëmshpërblimit përkatës, është shumë e gjatë dhe jo e justifikuar. Gjithashtu veçojmë faktin se në drejtim të KShH nuk ka pasur asnjë njoftim zyrtar nga autoritetet shtetërore mbi kalimin e shumës monetare në favor të shtetasit Strazimiri. KShH vlerëson si problematike mungesën e një njoftimi zyrtar nga ana e autoriteteve shtetërore lidhur me ekzekutimin e pagesave për kostot dhe shpenzimet gjyqësore në favor të përfaqësueve ligjorë të këtij shtetasi.

2.2. Vendimi i Gjykatës së Lartë Shqiptare, pas vendimmarrjes së GJEDNJ

Para se ti drejtohej GJEDNJ, KShH ndihmoi kërkuesin t'i drejtohej Gjykatës së Lartë kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë që la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë, të vitit 2014, e cila rrëzoi kërkesën e tij për ndërprerjen e trajtimit çnjerëzor dhe vendosjen e tij në një institucion të posaçëm mjekësor, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë. Por edhe pse rekursi u përcoll në Gjykatën e Lartë në Janar të vitit 2016, për shkak të stokut të lartë të çështjeve në shqyrtim të kësaj gjykate, vendimmarrja e saj datoi në Korrik të vitit 2021, pra 5 vite më vonë.

Kolegji Penal nisur nga rëndësia e çështjes, bazuar në nenin 437/1/b të K.Pr.Penale çmoi të nevojshme shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve dhe dëgjimin e tyre për shkak të problematikës dhe kompleksitetit të çështjes. Me vendimin nr. 18 në datë 15.07.2021 Gjykata e Lartë vendosi⁸ pranimin e kërkesës së kërkuesit Arben Strazimiri i cili përfaqësohej nga avokatët e KShH, duke disponuar mbi ndërprerjen e trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues ndaj shtetasit Arben Strazimiri, vendosjen e tij në një institucion mjekësor të specializuar, sipas ligjit nr. 79/2020, datë 25.06.2020, “Për ekzekutimin e vendimeve penale” dhe ligjit nr. 81/2020, datë 25.06.2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Ashtu si vendimi i GJEDNJ-së, edhe ky vendim gjyqësor i

⁵ Njëpërmjet shkresës nr. 773/41 prot. dt. 03.11.2021

⁶ Shkresë nr. 74 prot., dt. 30.01.2023

⁷ Shkresë nr. 259 prot., dt. 14.04.2023

⁸ Kolegji vlerësoi se vendimi nr. 2206, datë 22.01.2015, i Gjykatës së Apelit Tiranë si dhe vendimi nr. 1394, datë 20.11.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duhen ndryshuar.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

brendshëm përfundimtar dhe me karakter detyrues nuk është ekzekutuar. Kërkuesi vijon të mbahet i akomoduar në një institucion penitenciar, IEVP Shën Koll, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Pavarësisht se vendosja e një pjese të shtetasve me masë mjekësore mjekim i detyruar, në këtë institucion, u prezantua nga autoritetet si një masë e përkohshme me natyrë tranzitore, në fakt nuk rezultojnë e tillë. Gjithashtu, për shkak të problematikave që KShH ka vërejtur në misionet e saj të monitorimit, vërehet se ky institucion nuk përmbush kriteret ligjore të një institucioni të posaçëm mjekësor dhe as standardet që GJEDNJ ka referuar në urdhërimin për vendimmarrjen Strazimiri kundër Shqipërisë.

2.3. Vijon mungesa sistematike e një institucioni të posaçëm mjekësor (gjetjet dhe konkluzionet nga misioni tematik monitorues i KShH-së pranë IEVP Shënkoll, Lezhë)

Në sajë të bashkëpunimit që KShH ka me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (DPB) u informuam se në fund të nëntorit të vitit 2021, u menaxhua dhe u krye me sukses procesi i transferimit nga IEVP Krujë (Zahari) i 314 shtetasve me masë mjekësore (nga këta 217 shtetas me masë mjekësore ‘shtrim i detyruar’ dhe 97 shtetas me masë ‘shtrim i përkohshëm’)⁹. Këta shtetas rezultojnë se u akomoduan pranë 2 godinave të IEVP Shënkoll (Lezhë)¹⁰. Ndërkohë, shtetasat vajza dhe gra për të cilat Gjykata ka caktuar masë mjekësore, vijnë të jenë të akomoduar e të trajtohen në ambientet e Qendrës Spitalore të Burgjeve Tiranë. Ky proces shënoi edhe mbylljen zyrtare të IEVP Krujë (Zahari), i njohur si burgu më problematik sa i takon kushteve infrastrukturore të varfra që vendosnin në mënyrë të dukshme, shtetasit e akomoduar, në kushtet e trajtimit me elementë çnjerëzor dhe degradues.

Me qëllim verifikimin e nivelit të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të kësaj kategorie shtetasish, të akomoduar në IEVP Shënkoll (Lezhë), një ekip i vëzhguesve të KShH-së ndërmorën një mision monitorimi tematik në Mars të vitit 2023. Disa nga gjetjet dhe rekomandimet kyçe i janë përcjellë IEVP-së së monitoruar, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Ministrive të linjës (asaj të Drejtësisë dhe asaj të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale).

- a) Në ditën e monitorimit, në institucion ishin të akomoduar 230 pacientë me masë mjekësore “Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor” dhe 174 shtetas nën masën e sigurimit personal “Shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik”, ndërkohë që kapaciteti zyrtar i institucionit është 186 persona. KSHH konstatoi me shqetësim se ky institucion ndodhej në kushtet e një mbipopullimi shqetësues. Kjo situatë përbën cenimin e Rregullit 18.4 të Rregullave Europiane të Burgjeve, si dhe standardeve të elaboruara nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose

⁹ Shkresa nr. 12815/2 prot., dt. 03.12.2021, drejtuar KShH-së nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

¹⁰ IEVP Lezhë, përmes Urdhërit 8927/1 prot., dt 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë është klasifikuar Burg i Sigurisë së zakonshme, me një seksion të vecantë për trajtimin e shtetasve me masë mjekësore ‘mjekim i detyruar’.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Ndëshkimin Çnjerëzor ose Degradues (CPT)¹¹, si dhe praktika e konsoliduar e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.¹²

- b) Shtetasit e vendosur nën “masë mjekësore”, pas mbylljes së IEVP Zahari (Krujë), ende vijojnë të qëndrojnë të akomoduar në ambiente të papërshtatshme të cilat nuk sigurojnë trajtim adekuat mjekësor të posaçëm për kushtet shëndetësore të këtyre shtetasve si dhe i vendosin ata në kushtet e kufizimit të lirisë sipas një regjimi penitenciar¹³. Godina IV dhe V e IEVP Shënkoll (Lezhë) ku këta shtetas janë akomoduar, vlerësojmë se nuk janë të ndërtuara sipas standarteve që duhet të përmbushë një institucion shëndetësor i posaçëm. Vërehet se këto godina janë projektuar si godina burgu dhe janë të pajisura me dyer të rënda metalike, pra institucione të mirëfillta të natyrës penitenciare. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë kushtet jo të mira infrastrukturore dhe mungesën e hapësirave të përshtatshme sociale e rekreative, këto ambiente në IEVP Shënkoll nuk përmbushin kushtet e standardit minimal të një mjedisi terapeutik për pacientët e akomoduar.
- c) Referuar të dhënave që KShH disponon nga misionet e mëhershme verifikimi në IEVP Zahari, në vitin 2018, është raportuar mbajtja në atë kohë e 88 pacientëve, të kategorizuar në 34 persona me masën e sigurimit “Shtrim i përkohshëm” dhe 54 persona me masë mjekësore “Mjekim i detyruar”.¹⁴ Aktualisht, vërehet me shqetësim një 4.5 fishim i numrit të këtyre pacientëve të akomoduar në IEVP Shën Koll, ose 316 më shumë, në krahasim me 5 vite më parë. Duke mbajtur në konsideratë disproporcionalitetin ndërmjet kapaciteteve aktuale infrastrukturore, por edhe pamjaftueshmërisë së burimeve njerëzore, KShH vlerëson se trajtimi i përshtatshëm i këtyre shtetasve, konform kërkesave të vendimmarrjes së GJEDNJ në çështjen Strazimiri si dhe në referencë të standardeve ndërkombëtare, është pjesërisht i munguar. Akomodimi aktual i shtetasve në dy godinat e IEVP Shënkoll, cënon veçanërisht standardet e Rregullit 12.1 të Rregullores Europiane të Burgjeve.¹⁵
- d) Sa i përket kushteve infrastrukturore, me shqetësim u vërejt prania e lagështirës në korridoret e godinave 4 dhe 5, papërshtatshmëri e kushteve në dhomën e kufizimit fizik, ambientet e zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta dhe mjediset e ajrimit. Kushtet aktuale janë të pamjaftueshme, mbartin premisa për cenimin e dinjitetit njerëzor të këtyre pacientëve si dhe nuk garantojnë një mjedis risocializues dhe adekuat për ta.

¹¹ Sipas Raportit të Përgjithshëm nr. 31 të CPT, “Mbipopullimi mund ta kthejë një burg në një depo njerëzore dhe të minojë çdo përpjekje për t’i dhënë kuptim praktik ndalimit të torturës dhe formave të tjera të keqtrajtitimit. Mungesa e hapësirës personale dhe e privatësisë i vë në rrezik të gjithë të burgosurit, veçanërisht ata më vulnerabël”, i aksesueshëm në: <https://rm.coe.int/1680a63c72>

¹² Në një sërë çështjesh të Gjykatës Europiane të të Drejtave është konstatuar cenim i nenit 3 të Konventës. Neshkov dhe të tjerët kundër Bullgarisë, 2015); Varga dhe të tjerët kundër Hungarisë, 2015; Torreggiani dhe të tjerët kundër Italisë, 2013; Sukachov kundër Ukrainës, 2020 etj

¹³ Masa e sigurimit personal “Shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik”, e parashikuar nga neni 239 K.Pr.P. duhet të ekzekutohet në ambientet e një spitali psikiatrik civil. Ndërsa masa mjekësore “Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor”, sipas nenit 46 K.P. dhe nenit 28 pika 1 dhe 2 të Ligjit nr. 44/2012, “Për shëndetin mendor”, i ndryshuar, ekzekutohet pranë Institucioneve Mjekësore të Posaçme, pjesë e sistemit shëndetësor të integruar të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

¹⁴ <https://ahc.org.al/gjendje-e-rende-e-personave-me-probleme-te-shendetit-mendor-ne-sistemin-e-burgjeve/>

¹⁵ Sipas këtij Rregulli parashikohet se “Personat që vuajnë nga sëmundje mendore dhe gjendja e shëndetit mendor të të cilëve është e papajtueshme me ndalimin në burg duhet të akomodohen në një institucion të krijuar posaçërisht për këtë qëllim. Nëse persona të tillë do të mbahen në IEVP, në kushte të jashtëzakonshme, duhet të ketë rregullore të posaçme që merr parasysh statusin dhe nevojat e tyre.”



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- e) Sa i përket situatës në sektorin e shërbimeve të çështjeve shoqërore, u evidentuan disa parregullsi në dokumentimin dhe mirë-administrimin e dosjeve personale psiko- sociale nga ana e stafit përgjegjës institucional, ku përfshihet mungesa e dokumentimit të planit të trajtimit në mënyrë periodike. Dosjet nuk plotësoheshin në mënyrë të rregullt, ndërkohë që mbajtja e shënimeve lidhur me shërbimet psiko sociale dokumentohej vetëm në blloqet personale të specialistëve të edukimit. Kjo praktikë nuk garanton respektim të trajtimit të individualizuar psiko-social të shtetasve, siç parashikohet në nenet 13, 14 pika 2 të ligjit nr. 81/2020 dhe nenit 3 pika 3, 20 pika 1 gërma k) të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.
- f) Referuar gjendjes në sektorin e shërbimit shëndetësor, u konstatuan vakanca në organikën e miratuar të këtij institucioni. Konkretisht, numërohen 5 vende vakante në sektorin e shëndetësisë.¹⁶ Gjithashtu, janë konstatuar 3 vakanca sa i takon pozicionit “kujdestar për pacientët me masë mjekësore”. Kryerja e vizitave mjekësore realizohej kryesisht me kërkesë të shtetasve dhe vetëm për ato raste që kishin nevojë për mbikëqyrje të vazhdueshme dhe periodike mund të kryheshin vizita pa kërkesë paraprake. Kjo formë e trajtimit të tyre nuk garanton mbikëqyrje sistematike mjekësore, nga ana e stafit mjekësor, në çdo kohë dhe pa vonesa. Këto situata të konstatuara reflektojnë mungesën e ndjekjes periodike dhe të individualizuar të trajtimit mjekësor, detyrim ky i parashikuar në nenet 13 të ligjit nr. 81/2020 dhe 19 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.
- g) Sa i takon shtetasve diabetikë, pacientë të akomoduar në I EVP Shënkoll me masë mjekësore apo shtrim i përkohshëm në spital psikiatrik, periodiciteti i kryerjes së analizave për matjen e diabetit, ishte i ulët. Gjithashtu, u evidentua se mungonte kryerja periodike e analizave të duhura me qëllim vlerësimin e mjekimit të nevojshëm.¹⁷ Kjo praktikë e konstatuar, nuk garanton respektimin e nenit 41 të ligjit nr. 81/2020. Për këta shtetas, rezultoi se nuk kishte një dietë të specifikuar ushqimore, fakt i cili bie ndesh me nenin 36 të ligjit nr. 81/2020 dhe rregullin 22.1, të Rregullores Europiane të Burgjeve, dhe nuk garanton sigurimin e ushqimit të shëndetshëm dhe të mjaftueshëm në përputhje me gjendjen shëndetësore të këtyre shtetasve.
- h) Referuar praktikës së evidentuar për procedurat e kufizimit fizik të shtetasve me masë mjekësore, u konstatua se jo në çdo rast në regjistrin e kufizimit fizik evidentohen rastet konkrete, të cilave i nënshtrohen pacientët. Gjithashtu, është konstatuar në 2 raste vendosja e shtetasve në kushtet e kufizimit fizik më tepër se 24 orë. Kjo situatë bie ndesh me nenin 96, pika 7 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, e cila parashikon në mënyrë eksplicite se izolimi në një dhomë të veçuar, si mjet kufizimi i përkohshëm, përdoret vetëm përjashtimisht dhe vetëm për pak orë dhe në çdo rast nuk duhet të kalojë 24 (njëzet e katër) orë.

Në muajin Maj 2023, KShH ka adresuar gjetjet dhe rekomandimet konkrete institucioneve përgjegjëse si institucionit të monitoruar I EVP Shënkoll, Drejtorisë së Përgjithshme të

¹⁶ Sipas organikës së miratuar të I EVP Shënkoll, në këtë sektor duhet të jenë të punësuar 22 punonjës, ndërkohë që janë konstatuar 5 vakanca në pozicionin e mjekut kardiolog, mjek psikiatër, mjek laborant klinik biokimik dhe infermier(2).

¹⁷ Këta shtetas i nënshtrohen analizave minimalisht një herë në tre muaj, e më konkretisht, matjes së “diabetit momental”. Vëzhguesit e KShH vlerësojnë që kjo praktikë nuk është e mjaftueshme për të vlerësuar mjekimin përkatës të shtetasve diabetikë të akomoduar, për shkak se për vlerësimin e tij, duhet të kryhet analiza specifike e “hemoglobinës së glukozuar”, dhe jo matja e diabetit momental, që është një matje që bëhet çdo ditë, me qëllim monitorimin e vazhdueshëm të ecurisë së shtetasve diabetikë.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Burgjeve, Ministria e Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por nga ana e këtyre institucioneve nuk ka ende një përgjigje, përveç IEVP Shënkoll, i cili ka referuar se kjo kategori shtetasish janë të akomoduar pranë IEVP Lezhë si masë tranzitore, derisa të merret përfundimisht nën përkujdesje nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. IEVP Shënkoll, deri në momentin e kalimit të këtyre shtetasve në një institucion të përshtatshëm, ka kërkuar bashkëpunimin e KShH për vënien në dijeni të Ministrisë së Drejtësisë mbi ecurinë dhe nivelin e realizueshmërisë së rekomandimeve të KShH.

3. Vështrim mbi ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, *Zaharia k. Shqipërisë*

Në çështjen *Zaharia k. Shqipërisë*¹⁸, pas dështimit të përpjekjeve për të arritur një zgjidhje me marrëveshje, më dt. 9 Nëntor 2021, Komiteti me tre gjyqtarë i Gjykatës Europiane vendosi të ç'regjistrojë kërkesën e ankuesit Fotaq Zaharia, pasi ka pranuar deklaratën e njëanshme të Qeverisë Shqiptare. Në këtë deklaratë të njëanshme, Qeveria Shqiptare shpreh keqardhjen që kërkuesi i është nënshtruar një trajtimi çnjerëzor dhe poshtërues, në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, duke u zotuar ndër të tjerash se:

“Autoritetet, marrin përsipër që kërkuesi të ekzaminohet nga një ekip mjekësh specialistë, brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës Evropiane, me qëllim rivlerësimin e gjendjes aktuale shëndetësore të tij dhe dhënien e rekomandimit, për ndërhyrjet kirurgjikale që mund të përmirësojnë gjendjen e tij shëndetësore. Në përputhje me ligjin dhe procedurat e brendshme, aplikantit do t'i ofrohet mundësia të caktojë një mjek të zgjedhur prej tij për t'u bërë anëtar i ekipit të mjekëve specialistë.

Në varësi të sigurimit të prokurimit të çdo medikamenti dhe/ose pajisjeje mjekësore, si dhe pëlqimit me shkrim të aplikantit për çdo ndërhyrje kirurgjikale, autoritetet marrin përsipër të zbatojnë, brenda tre muajve nga ky vendim, rekomandimet që do të bëhen nga ekipi i mjekëve specialistë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, kryerjen e çdo ndërhyrjeje kirurgjikale në Qendrën Spitalore Universitare të Tiranës [Qendrën e Traumës] ose një spital tjetër civil ekuivalent shtetëror, me të njëjtat kushte si ato të vëna në dispozicion ndaj publikut të gjerë dhe që mbulojnë nga sistemi i kujdesit shëndetësor publik shqiptar.

Qeveria deklaron se është e gatshme të paguajë 13,000 euro (trembëdhjetë mijë euro) për të mbuluar çdo dëm material dhe jomaterial, si dhe 2,000 euro (dy mijë euro) për të mbuluar të gjitha shpenzimet plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet aplikantit. Në rast të dështimit të pagesës së këtyre shumave brenda periudhës tre mujore në fjalë, qeveria merr përsipër të paguajë interes të thjeshtë për to.”

Në vendimmarrjen e saj, ndër të tjera, GJEDNJ-ja ka theksuar se, në rast se nëse Qeveria nuk respekton kushtet e deklaratës së njëanshme, kërkesa do të rikthehet në listën e çështjeve të GJEDNJ, në respektim të nenit 37§2 të Konventës (duke marrë si referencë çështjen, *Josipović kundër Serbisë*, nr. 18369/07, 4 mars 2008).¹⁹

¹⁸ Në kuadër të gjykimit të aplikimit Zaharia kundër Shqipërisë mbi kërkesën nr. [45022/16](#).

¹⁹ Vendim Kërkesa nr. 45022/16 Fotaq Zaharia kundër Shqipërisë § 22



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

3.1. Ri-ekzaminim mjekësor pa rezultat dhe zgjidhje efektive për problematikën sistematike shëndetësore të rënduar të kërkuesit

KShH vëren se, deklarata e njëanshme e Qeverisë Shqiptare për ri-ekzaminimin shëndetësor të kërkuesit, nuk ka sjellë asnjë efekt pozitiv për trajtimin dhe zgjidhjen e problematikës shëndetësore të tij. Gjendja shëndetësore e shtetasit Fotaq Zaharia, vijon të jetë veçanërisht e rëndë dhe I EVP pranë së cilës ky shtetas është akomoduar, pranon se nuk i plotëson kushtet për terapi efektive.²⁰

Paralelisht, KShH ka vijuar të përfaqësojë në gjykatat vendase, proceset gjyqësore të nisura më herët për këtë shtetas, para se ai ti drejtohej GJEDNJ-së. Për shkak të vonësive të krijuarasi rezultat i vakancave nga procesi i vettingut, procesi gjyqësor në Gjykatën e Apelit me objekt: “Lirimi i kërkuesit Fotaq Zaharia për shkak të mbajtjes së tij në kushte çnjerëzore dhe degraduese, të papajtueshmërisë së gjendjes së tij shëndetësore me burgimin, gjendje e cila i rrezikon shëndetin dhe jetën e tij”, zgjati afro 3 vite e gjysmë. Me Vendimin nr. 567 dt. 14.06.2022 Gjykata e Apelit Tiranë vendosi prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

Pas këtij vendimi, fillimisht përpara Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë dhe më pas përpara Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, nisi gjykimi i çështjes me objekt: *“Lirimin e kërkuesit Fotaq Zaharia për shkak të mbajtjes së tij në kushte çnjerëzore dhe degraduese, të papajtueshmërisë së gjendjes së tij shëndetësore me burgimin, gjendje e cila rrezikon shëndetin dhe jetën e tij.”*²¹ Më datën 12 Qershor 2023, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë shpalli me vendim moskompetencën për gjykimin e kësaj çështje me arsyetimin se kërkesa duhet të gjykohet nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, nën kompetencën territoriale të së cilës ndodhet I EVP Krujë, vendi ku kërkuesi ka qenë i akomoduar në kohën kur ka ngritur kërkesën. Më herët për këtë çështje, me Vendimin e datës 21.03.2023 Gjykata e Shkallës së Parë Krujë, kishte shpallur moskompetencën për gjykimin e kërkesës së kërkuesit, me argumentimin se kjo çështje duhet të gjykohet nga Gjykata në territorin e të cilës ndodhet I EVP-ja ku aktualisht ekzekuton dënimin me burgim kërkuesi. Në këto kushte, mosmarrëveshja e kompetencave ndërmjet dy gjykatave do të zgjidhet me vendim nga Gjykata e Lartë. Pavarësisht se mosmarrëveshjet mbi kompetencat lëndore apo territoriale janë situata normale ligjore në veprimtarinë e Gjykatave vendase, institucionet shtetërore po dështojnë t’i ofrojnë një zgjidhje të përshtatshme shtetasit Fotaq Zaharia për gjendjen e rëndë shëndetësore, çka nuk përmbush zotimet e shtetit shqiptar, në deklaratën e njëanshme të pranuar nga GJEDNJ-ja. Kërkesa e mësipërme, me objekt: *“Lirimin e kërkuesit Fotaq Zaharia...”* është depozituar prej kërkuesit, në datën 7 Korrik 2017 dhe ende nuk ka mundur të marrë një zgjidhje ligjore nga gjykatat shqiptare, pavarësisht gjendjes shëndetësore në të cilën ai ndodhet.

Lidhur me ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, për ekzaminimin nga një grup mjekësh të shtetasit Fotaq Zaharia, ky proces duhej të përmbyllej brenda datës 9 Mars 2022, evidentuar kjo edhe në komunikimet zyrtare ndërmjet institucioneve.²² Si pasojë e neglizhencës dhe

²⁰ Shkresa nr. 4509 prot. datë 18.04.2022 e I EVP Lezhë drejtuar KShH-së

²¹ Ky gjykim mbeshtetet në Vendimin nr. 567 datë 14.06.2022 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

²² Shkresa nr. 308 prot. datë 14.04.2022

Shkresa 678/4 datë 29.04.2022 e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Drejtuar Spitalit Universitar të Traumës



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

mungesës së koordinimit efektiv ndërmjet institucioneve përgjegjëse, si dhe sfidave me të cilat vetë kërkuesi (me anë të familjarëve dhe avokatëve të KShH-së) kanë ndeshur për të identifikuar mjekun specialist ortoped/ortoped-traumatolog që do të ishte pjesë e komisionit mjekësor të riekzaminimit të tij mjekësor, ky afat është tejkaluar. Sfida më madhore në këtë drejtim ishte hezitimi nga ana e mjekëve të specializuar të fushës për të ofruar kontributin e tyre të pavarur, të paanshëm e objektiv, pavarësisht se KShH publikoi një thirrje publike për shprehje interesi, për të ofruar këtë ekspertizë kundrejt pagesës, e cila iu drejtua dhe dërgua elektronikisht, disa institucioneve private të kujdesit shëndetësor. Procesi i përzgjedhjes së mjekut specialist u përball me vështirësi, për shkak të mungesës së shprehjes së interesit, ndërkohë që u bë e mundur përmbyllja e tij me sukses në muajin Shtator 2022. Më datë 6 Tetor 2022 pranë Spitalit Universitar të Traumës u realizua ekzaminimi mjekësor i shtetasit Fotaq Zaharia nga mjekët Prof. Asoc. Vilson Ruçi, Dr. Shk. Artan Distafa dhe Dr. Alfred Cake²³. Pjesë e ekzaminimit u bë edhe Dr. Dion Riza, i caktuar nga kërkuesi dhe familjarët e tij, ndërkohë që avokati i caktuar nga KShH për kërkuesin ndoqi procesin para dhe gjatë kryerjes së ekzaminimit nëpërmjet korrespondencës zyrtare me institucionet përgjegjëse²⁴ dhe prezencës fizike gjatë zhvillimit të konsultës.

Mendimi profesional i ekipit të mjekëve specialistë, pjesë e Komisionit të ngritur për riekzaminimin e gjendjes së tij shëndetësore u zbardh dhe u përcoll në rrugë postare drejt KSHH në muajin Janar 2023²⁵. Rrjedhimisht, u konstatua një vonesë tjetër, me 3 muaj, për zbardhjen dhe përcjelljen e konsultës mjekësore të zhvilluar më herët pranë Spitalit Universitar të Traumës. Konsulta e zgjeruar e mjekëve specialistë konkludoi se rasti përbën një veçanti dhe se pacienti tashmë është një invalid i përjetshëm, pa mundësi reale për t'u rikuperuar qoftë edhe pjesërisht. Vlerësimi i pasqyruar nga ekipi i mjekëve specialistë reflekton një pamundësi substanciale të autoriteteve shëndetësore për të ekzekutuar plotësisht vendimin e GJEDNJ-së, i bazuar në angazhimet e marra përsipër nga Qeveria Shqiptare.

Ndodhur në këto kushte, duke qenë se Qeveria Shqiptare ka dështuar në përmbushjen e kushteve të përcaktuara në Deklaratën Unilaterale të saj, të lidhura me trajtimin e përshtatshëm shëndetësor të kërkuesit, në muajin Qershor 2023, në respektim të nenit 37§2 të Konventës, dhe praktikës së konsoliduar të GJEDNJ-së, KShH ka kërkuar nëpërmjet një shkresë zyrtare nga ana e Departamentit për Ekzekutimin e Vendimeve të kësaj gjykate, marrjen në konsideratë të mundësisë për rikthimin në listën e çështjeve për gjykim, të kësaj kërkesë. Mbetemi ende në pritje të vendimmarrjes së GJEDNJ-së mbi këtë kërkesë.

3.2.Vonesë në ekzekutimin e dëmshpërblimit monetar dhe jomonetar ndaj kërkuesit

²³ Ngritja e Komisionit Ekzaminues pranë Spitalit Universitar të Traumës u njoftua me shkresën nr. 1542/1 prot. date 21.07.2022 dhe shkresën 2163/1 prot. datë 03.10.2022

²⁴ Shkresa nr. 411 prot. datë 13.07.2022 e KShH drejtuar Spitalit Universitar të Traumës dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

Shkresa nr. 490 prot. datë 29 Shtator 2022 e KShH drejtuar Spitalit Universitar të Traumës;

Shkresa nr. 508 datë 12 Tetor 2022 e KShH drejtuar Spitalit Universitar të Traumës;

Shkresa nr. 697 prot. datë 29 Dhjetor 2022;

Shkresa nr. 219 prot. datë 25 Mars 2022 e KShH drejtuar Avokaturës së Shtetit;

Shkresa nr. 445/4 prot. datë 14.04.2022 e Avokaturës së Shtetit drejtuar KShH;

²⁵ Nëpërmjet shkresës nr. 3/1 datë 06.01.2023.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Duke mbajtur në konsideratë kushtet e vështira socialo ekonomike të kërkuesit, i cili ndodhet në kushtet e paaftësisë paguese për shkak të privimit të tij nga liria²⁶, si dhe familjarëve të tij, prej muajit Shtator 2022, KShH ka kërkuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë²⁷ marrjen e masave konkrete e të menjëhershme për planifikimin e ekzekutimit e dëmshpërblimit përkatës. Për një periudhë afro 7 mujore, deri në muajin Mars 2023, nga ana e këtij institucioni nuk kemi pasur asnjë përgjigje konkrete lidhur me to. Mungesa e informacionit periodik dhe sistematik mbi ekzekutimin e kësaj vendimmarrje, si pjesë e rëndësishme e detyrimeve ndërkombëtare të marra përsipër në kuadër të aderimit të Shqipërisë në KEDNJ-së, na detyroi që në fund të muajit Mars 2023 t'i drejtoheshim sërish me një kërkesë për informacion kësaj Ministrie. Rreth një muaj më vonë, institucioni reagoi nëpërmjet shkresës zyrtare të dt. 28.04.2023²⁸, me anë të së cilës, u informuam se Këshilli i Ministrave ka marrë vendim për ekzekutimin e kësaj vendimmarrje prej muajit Qershor 2022. Ndërkohë në muajin Korrik 2022, Ministria ka bërë të mundur depozitimin e fondeve (principal dhe interesa) në llogarinë e çelur për këtë çështje. KShH në cilësinë e mbrojtësit ligjor të kërkuesit, vëren me shqetësim, periudhën e gjatë kohore (rreth 10 muaj) që i është dashur autoritetit publik (konkretisht Ministria e Financave dhe Ekonomisë) për informimin e avokatëve të kërkuesit mbi ekzistencën e një llogarie bankare të çelur për këtë rast, si dhe adresimin ndaj nesh të kërkesave që duhet të plotësohen nga kërkuesi Zaharia, përkatësisht dokumentacionit si kartë identiteti dhe numër llogarie të përfituesit, elementë të cilët mundësojnë kalimin e shumës monetare në llogari personale.

Pas njohjes me këtë informacion, KShH kërkoi nga ana e IEVP Lezhë, marrjen e masave për hapjen e llogarisë bankare të shtetasit të dënuar Fotaq Zaharia²⁹. Nga ana e këtij institucioni është mundësuar hapja dhe përcjellja e të dhënave bankare, nëpërmjet shkresës nr. 6390 prot., dt. 26.05.2023. Kjo e dhënë u përcoll nga ana e mbrojtësve ligjorë të kërkuesit në adresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke vënë në dijeni edhe institucionin e Avokaturës së Shtetit. KShH mbetet ende në pritje të procedurave që do të ndërmerren nga autoritetet përgjegjëse për ekzekutimin e plotë të dëmit material dhe jomaterial të marrë përsipër në deklaratën e njëanshme të qeverisë shqiptare, e pranuar si rrjedhojë në vendimmarrjen e GJEDNJ-së për ç' regjistrimin e kësaj çështje nga lista e çështjeve në gjykim.

4. Vështrim mbi ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, Prizreni k. Shqipërisë

Në çështjen Prizreni kundër Shqipërisë, që i korrespondon kërkesës nr. 29309/16, GJEDNJ, më datë 11.6.2019, vendosi deklarin e kërkesës si të pranueshme për shkak të cenimit të garancive procedurale të neneve 2 (e drejta e jetës) dhe 3 (ndalimi i torturës) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. GJEDNJ, vendosi ndaj shtetit shqiptar detyrimin për të dëmshpërblyer kërkuesin në shumën:

²⁶ Neni 41 pika 2 të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, si dhe VKM nr. 337, dt. 06.04.2011 “Për përfshirjen e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë”

²⁷ Shkresa nr. 468 prot. datë 14 Shtator 2022 e KShH për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë; Shkresa nr. 233 prot. datë 31 Mars 2023 e KShH për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;

²⁸ Me anën e shkresës nr. 6452/1 prot. datë 25.04.2023

²⁹ Nëpërmjet shkresës nr. 371 prot., dt. 18.05.2023 të KShH-së



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

"12 000 euro (dymbëdhjetë mijë euro) plus çdo taksë e cila mund të tarifohet, për demin jomonetar, shumë e cila duhet të konvertohet në monedhën e shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

1 450 euro (një mijë e katërqind e pesëdhjetë euro), plus çdo taksë, e cila mund të jetë e tarifueshme për kërkuesin, për kostot dhe shpenzimet;

se nga përfundimi i tre muajve të përmendur më sipër, deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të jetë i pagueshëm për shumat më sipër, në një normë të barabartë me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane, gjatë periudhës së vonesës, plus tre pikë përqindjeje".

Pasi ky vendim mori statusin e vendimit përfundimtar³⁰, Qeverisë Shqiptare iu deshën rreth 3 vite e 3 muaj për të marrë vendim për ekzekutimin e kësaj vendimmarrje.³¹

Përpara se kjo vendimmarrje të ishte nën shqyrtim të mbledhjes së Qeverisë Shqiptare, në muajin Janar 2021 avokatët e KShH-së informuan institucionin e Avokaturës së Shtetit, mbi shkresat nr. 614, dt. 22.11.2019 dhe nr. 619, dt. 25.11.2019 të përcjella pranë GJEDNJ-së. Me anë të tyre, KShH synonte të informonte Departamentin për Ekzekutimin e Vendimeve të të kësaj gjykate, mbi të dhënat bankare të subjekteve ku do të depozitohen shumat përkatësetë akorduara në zbatim të vendimmarrjes gjyqësore, në kuadër të dëmit jo-material dhe shpenzimet e taksat gjyqësore.

Pavarësisht përcjelljes së këtyre të dhënave elektronikisht pranë institucionit të Avokaturës së Shtetit, ende nuk është përcjellë një përgjigje zyrtare mbi hapat e ndërmarrë. Pas interesimit individual të kërkuesit pranë zyrave të KShH-së është bërë e mundur përcjellja në rrugë zyrtare e kopjes së dokumentit të identifikimit dhe të dhënave të llogarisë bankare në adresëtë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke mbajtur për dijeni institucionin e Avokaturës së Shtetit. Mbrojtësit ligjorë të kërkuesit mbeten ende në pritje të masave që do të ndërmerren nga autoritetet përgjegjëse për ekzekutimin e kësaj vendimmarrje gjyqësore.

³⁰ Datë 11.09.2019

³¹ VKM nr. 860, datë 27.12.2022 "PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 11.6.2019, PËR ÇËSHTJEN "PRIZRENI KUNDËR SHQIPËRISË" (PËR KËRKESËN NR. 29309/16)"